

PROCEDURA

**PËR KOMUNIKIM
ME QYTETARË QË KANË
NJË LLOJ DHE SHKALLË TË CAKTUAR
TË PENGESAVE**

**PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT: “ADMINISTRATË
E QASSHME PËR PERSONAT ME HANDIKAP”**

Programi për
sigurimin e
qasjes në
medium, për
personat me
pengesa në
shqisa

Procedura është e miratuar në kontekst të realizimit të
Programit të Agjencisë për sigurimin e qasjes në media, për
personat me pengesa në shqisa, si dhe për realizimin e
projektit: “Administratë e qasshme për personat me handikap”

Neni 1

Me këtë procedurë përcaktohet mënyra e sigurimit të qasjes deri te shërbimet e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (më tutje ASHMAA) për personat me pengesa, mënyra e komunikimit me ta, obligimet e personave përgjegjës për komunikim me bashkëqytetarët me pengesa, evidentimi i shërbimeve të ofruara/siguruara.

Neni 2

Qëllimi i kësaj procedure është që në ASHMAA të krijohen kushte për qasje më të lehtë deri te informatat dhe shërbimet, për personat me invaliditet.

Neni 3

ASHMAA me vendim të drejtorit emëron person përgjegjës për komunikim me qytetarët me pengesa dhe zëvendësin/sen e tij/saj (më tutje në tekst, persona përgjegjës për komunikim).

Neni 4

Të dhënat për personat përgjegjës për komunikim (emri dhe mbiemri, adresa, numrat e telefonit dhe adresa e postës elektronike) publikohen në ueb faqen e ASHMAA.

Neni 5

Personat përgjegjës për komunikim, gjatë orarit të punës, vazhdimisht janë në dispozicion për komunikim me personat me pengesa, ndërsa mënyra e realizimit të punës - drejtpërdrejtë, përmes postës elektronike ose përmes telefonit, varësisht nga nevojat, aftësitë dhe mundësitë e personit me invaliditet.

Personat përgjegjës për komunikim i ndërmarrin të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe të mundshme për realizimin e kërkesave që personat me invaliditeti i kanë ndaj ASHMAA, duke u udhëhequr nga udhëzimet e dhëna në *Kodin e sjelljes me personat me invaliditet* të IP Enti për punë sociale.

Neni 6

Personat përgjegjës për komunikimin, patjetër duhet të kenë trajnim adekuat të realizuar nga ana e IP Enti për punë sociale, në pajtim me Programin e projektit *Administratë e qasshme për personat me handikap*, për çka duhet të posedojnë edhe certifikatë përkatëse, të dhënë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe IP Enti për punë sociale.

Njohuritë e fituara gjatë trajnimit, që kanë të bëjnë me të drejtat e personave me invaliditet në pajtim me legjislacionin nacional dhe ndërkombëtar, mënyrat për tejkalimin e stereotipave, paragjykimeve dhe diskriminimit të personave me invaliditet, llojet e barrierave me të cilat ballafaqohen këta persona, karakteristikat themelore të personave me invaliditet dhe mënyrat e komunikimit në pajtim me llojin dhe shkallën e invaliditetit, personat përgjegjës për komunikimin, përmes procesit të mësimi organizativ, i bartin edhe te të punësuarit tjerë në ASHMAA.

Neni 7

Personat përgjegjës për komunikimin, pasi që do tu mundësojnë që personat me invaliditet të realizojnë të drejtat e tyre qytetare dhe ti shfrytëzojnë shërbimet e ASHMAA, në mënyrë obliguese e plotësojnë *Listën për përcjelljen e numrit të personave invalid të cilët kanë kërkuar asistencë gjatë realizimit të të drejtave të tyre*, listë kjo e shënuar edhe në Programin e projektit *Administratë e qasshme për personat me handikap*.

Ata, për realizimin e të drejtave dhe obligimeve, si dhe përdorimin e shërbimeve nga ana e personave me invaliditet, përpilojnë raport vjetor.

Neni 8

Kjo procedurë hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Shkup, _____ 2015

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuele**

Drejtör

dr. Zoran TRAJÇEVSKI